



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

KOMISIONI PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Dokument Parlamentar

RAPORT

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, REPUBLIKËS SË MALIT TË ZI DHE KOMISIONIT EVROPIAN, PËR PROGRAMIN E VEPRIMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR IPA II, MALI I ZI - SHQIPËRI, ALOKIMET E VITIT 2016”

Komisioni për Integrimin European (në vijim Komisioni), bazuar në Nenet 18, 32, 34 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e zhvilluar në datë 18.10.2018, me cilësinë e **Komisionit për dhënie mendimi**, mori në shqyrtim projektligjin *“Për Ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Evropian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi - Shqipëri, alokimet e vitit 2016”*

Për paraqitjen e këtij projektligji, në mbledhje ishte e pranishme Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme.

1. Qëllimi i projektligjit

Qëllimi i këtij projektligji është ratifikimi i marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi - Shqipëri, alokimet e vitit 2016.

Programi BNK Mali i Zi - Shqipëri 2014-2020 u miratua nga Komisioni European me vendimin zbatues C(2014) 9352 të datës 10 dhjetor 2014. **Alokimet e vitit 2016 për këtë program** financohen nga një grant i Bashkimit European, nëpërmjet Instrumentit të Asistencës së Paraantarësimit (IPA II), me një vlerë prej 1 700 000 (një milion e shtatëqind mijë) euro për të dyja vendet, por, duke marrë parasysh edhe bashkëfinancimin kombëtar të dy shteteve (300 000 (treqind mijë) euro bashkërisht), **buxheti i përgjithshëm i programit për vitin 2016 arrin vlerën 2 000 000 (dy milionë) euro.**

Kontributi total që do të japë BE-ja për zbatimin e përbashkët të programit Mali i Zi - Shqipëri, për periudhën 2014-2020, arrin vlerën 11 900 000 (njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind) euro, por alokimet e mëtejshme do të jenë subjekt i nënshkrimit të marrëveshjeve të tjera financiare midis vendit tonë, Malit të Zi dhe Komisionit European, sikurse kanë qenë

edhe dy marrëveshje të tjera financimi, që janë konkluduar ndërmjet palëve për të njëjtin program (për alokimet e viteve 2014 dhe 2015), të cilat janë ratifikuar edhe nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (ligji nr.31/2016).

Përfitues të këtij programi do të jenë 3 zona në Shqipëri (Shkodra, Lezha, Rrethi i Tropojës) dhe 12 zona në Mal të Zi¹.

Objektivi i programit BNK Mali i zi - Shqipëri për vitet 2015-2017 është të kontribuojë në zhvillimin social-ekonomik të zonave ndërkufitare dhe të rrisë bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve nëpërmjet ndërhyrjeve të përbashkëta. Ky program mbështet shkëmbimin e përvojave dhe njohurive ndërmjet përfituesve si dhe përmirësimin e politikave publike ndërmjet autoriteteve kombëtare, rajonale dhe lokale në zonën e programit.

Nisur nga aspektet problematike që ndikojnë në ekonominë e zonës dhe për një zhvillim të qëndrueshëm, **Programi do të gjenerojë projekte në mbështetje të 3 akseve prioritare**, si më poshtë vijon:

1. Nxitja e turizmit dhe e trashëgimisë kulturore dhe natyrore;
2. Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut;
3. Nxitja e punësimit, lëvizjes gjeografike të punonjësve dhe përfshirjes sociale e kulturore përtej kufirit.

Një tjetër aks prioritar do t'i dedikohet asistencës teknike prej rreth 1 190 000 (një milion e njëqind e nëntëdhjetë mijë) eurosh për të gjithë periudhën e zbatimit 2014-2020, për të dyja vendet, që përbën 10% të buxhetit të përgjithshëm të programit. Kjo asistencë do të përdoret kryesisht për zbatimin efektiv, transparent dhe në kohë të programit të bashkëpunimit ndërkufitar nga ana e strukturave kombëtare dhe atyre teknike.

Marrëveshja e financimit për këtë program përbëhet nga vetë Marrëveshja (Kushtet e Veçanta) si dhe 8 Shtojcat e saj:

- **Shtojca I: Programi i veprimit BNK Mali i Zi - Shqipëri për vitet 2015 – 2017** - Vendim zbatues i Komisionit C (2015) 5235 i datës 22 korrik 2015, e cila përmban një përshkrim të modaliteteve të zbatimit të programit, përfshirë alokimet për secilin vit financiar, prioritetet e programit, kushtet e thirrjeve për projektpropozime dhe monitorimin e performancës së programit.
- **Shtojca IA: IPA II BNK 2014-2020, programi ndërmjet Malit të Zi dhe Shqipërisë**, e cila përmban një analizë të karakteristikave kryesore të territorit të lejueshëm e të prioriteteve dhe ofron një pasqyrë të sfidave të zhvillimit që rrethojnë zonën e programit, të cilat mund të trajtohen nëpërmjet projekteve të përbashkëta;
- **Shtojca II: Kushtet e përgjithshme**, parashikon përgjegjësitë dhe strukturat zbatuese të programit;
- **Shtojcat III** (Raporti vjetor model BNK për zbatimin e asistencës IPA II në përputhje me nenin 80 të marrëveshjes kuadër), **IIIA** (Raporti vjetor model për zbatimin e asistencës IPA II në përputhje me nenet 58 e 59 (1) të marrëveshjes kuadër) **dhe IV** (Modeli i raportit financiar, sipas nenit 59 (2) të marrëveshjes kuadër), të cilat paraqesin modelet e raportit vjetor të zbatimit për secilin program të bashkëpunimit ndërkufitar,

¹ Andrijeviça, Berane, Petnjica, Plavë, Gucia, Rozhajë, Podgoricë, Cetinje, Danilovgrad, Budva, Bar dhe Ulqin.

[Type here]

përfshirë dhe një raport të përbashkët për të gjitha programet e bashkëpunimit ndërkufitar që përfiton vendi ynë, pavarësisht zbatimit nën menaxhimin indirekt apo direkt nga ana e Komisionit Evropian;

- **Shtojca V: Specifikimet minimale të sistemit të kontabilitetit me bazë aktuale**, e cila parashikon kushtet që përfituesi IPA II duhet të plotësojë për ngritjen e sistemit të kontabilitetit;
- **Shtojca VI: Masat ad hoc për besimin e detyrave të zbatimit të buxhetit nën këtë program**, përveç detyrave të përfituesit IPA II, që është autoriteti kontraktues (Drejtoria e Financave dhe Administrimit të Fondeve të Ndihmës së BE-së (CFCU) në ministrinë malazeze të Financave) lidhur me besimin e detyrave të zbatimit të buxhetit të parashikuar në këtë marrëveshje financiare, në veçanti shtojcën II.

Mali i Zi dhe Shqipëria do të bashkëpunojnë ngushtë për koordinimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të programit. Struktura institucionale e programit është e përbërë nga autoriteti kontraktues i programit (Mal i Zi), Komiteti i Përbashkët i Monitorimit, Sekretariati i Përbashkët Teknik, si dhe koordinatorët kombëtarë të fondeve IPA të të dyja vendeve përfituese.

2. Plani Kombëtar për Integrimin European 2018-2020

Ky projektligj është në përputhje me objektivat strategjike dhe prioritetet e parashikuara në **Kapitullin 22 “Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore”** të Planit Kombëtar për Integrimin European (PKIE) 2018-2020.

3. Acquis e BE-së në fushën e veprimit të projektligjit

Acquis e BE-së në fushën e veprimit të projektligjit përbëhet nga legjislacioni parësor dhe dytësor.

- Legjislacioni parësor i BE-së

Traktati mbi Funkcionimin e Bashkimit European (TFBE) Neni 212.

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit BE - Shqipëri (MSA): Nenet 110, 112 dhe 113.

- Legjislacioni dytësor i BE-së

Rregullorja (BE) Nr.231/2014 e Parlamentit European dhe e Këshillit, datë 11 mars 2014, “*Mbi krijimin e Instrumentit për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA II)*”.

Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) Nr.447/2014, datë 2 Maj 2014, ‘*Mbi rregullat specifike për zbatimin e Rregullores (BE) Nr. 231/2014 të Parlamentit European dhe Këshillit, mbi krijimin e Instrumentit për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA II)*’.

Rregullorja (BE) Nr.236/2014 e Parlamentit European dhe e Këshillit, datë 11 mars 2014, “*Mbi përcaktimin e rregullave dhe procedurave të përbashkëta për zbatimin e instrumenteve të Bashkimit për financimin e veprimeve të jashtme*”.

Neni 212 i TFBE parashikon bashkëpunimin ekonomik, financiar dhe teknik të BE-së me vendet që nuk janë anëtare të BE-së. Pikat 2 dhe 3 të këtij neni përbëjnë bazën ligjore, për miratimin e akteve të BE-së për krijimin e programit IPA (pika 2) dhe për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare ndërmjet BE-se dhe Shteteve të Treta në këtë fushë (pika 3).

Neni 110 i MSA-së, parashikon se palët do të forcojnë bashkëpunimin për zhvillimin rajonal dhe vendor, me objektivin për të kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe reduktimin e pabarazive rajonale. Kujdes i veçantë do t'i kushtohet bashkëpunimit ndërkufitar.

transkombëtar dhe ndërrajonal. Bashkëpunimi merr në konsideratë fushat prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit në fushën e zhvillimit rajonal

Nenet 112 dhe 113 të MSA-së, parashikojnë se Shqipëria mund të marrë asistencë financiare nga Bashkimi European në formë granti dhe huaje, e cila mund të mbulojë të gjithë sektorët e bashkëpunimit dhe që do të orientohet drejt nevojave të konstatuara, përparësive të zgjedhura dhe kapacitetit për të thithur dhe për të dhënë rezultate, si edhe masave të marra për reformimin dhe ristrukturimin e ekonomisë.

Rregullorja IPA II (Nr.231/2014) krijon Instrumentin për Asistencën e Para-Anëtarësimit për periudhën 2014-2020. **Neni 2, pika 1, shkronja “a”, nënpika iii e Rregullores IPA II**, parashikon se ndihma do të ndjekë arritjen e objektivave specifike të pëcaktuar në këtë Rregullore, sipas nevojave të secilit prej përfituesve të IPA II si dhe agjendës së tyre individuale të zgjerimit, duke përfshirë, mbështetje për reformat politike nëpërmjet bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë.

Neni 3, pika 1, shkronja “e” e kësaj Rregulloreje parashikon se ‘bashkëpunimi rajonal dhe territorial’ përbën një nga 5 fushat prioritare të IPA II. Kurse, **pika 4 e këtij neni** parashikon se asistenca në fushën e politikave të përmendur në shkronjën “e” të pikës 1, mund të financojë në veçanti veprime që përfshijnë shumë vende si dhe veprime të bashkëpunimit ndërkufitar, transkombëtar dhe ndërrajonal. Gjithashtu **Aneksi III i kësaj Rregulloreje** përcakton prioritetet tematike që duhet të adresohen në kuadër të Asistencës që BE-ja jep për të mbështetur programet e bashkëpunimit ndërkufitar ndërmjet vendeve përfituese të IPA II.

Rregullorja Zbatuese IPA II (Nr.447/2014) përcakton rregullat specifike dhe kushtet e unifikuara për implementimin e Rregullores IPA II dhe rregulla të detajuara për implementimin e Rregullores për financimin e veprimit të jashtëm të BE-së (Nr.236/2014), si dhe rregullat specifike për bashkëpunimin ndërkufitar në fushën e ‘bashkëpunimit rajonal dhe territorial’. **Neni 6, pika 4 e kësaj Rregulloreje** parashikon se një marrëveshje e vetme financimi për programet e bashkëpunimit ndërkufitar, sikurse parashikohet në Titullin e VI, kapitulli i III të kësaj Rregulloreje, mund të nënshkruhet nga të gjitha vendet pjesëmarrëse në një program specifik. **Titulli i VI “Bashkëpunimi Ndërkufitar”, Kapitulli i III** i kësaj Rregulloreje parashikon rregullat specifike lidhur me programimin dhe zbatimin e asistencës financiare që BE-ja jep për të mbështetur programet e veçanta të bashkëpunimit ndërkufitar, ndërmjet dy apo më shumë vendeve përfituese të IPA II.

4. Përfundime

Projektligji “Për Ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Evropian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi - Shqipëri, alokimet e vitit 2016”, nuk synon të përafrojë ndonjë akt të veçantë të legjislacionit të BE-së.

Pavarësisht kësaj, ky projektligj është në përputhje me:

- **Nenin 110 të MSA-së** që parashikon se palët do të forcojnë bashkëpunimin për zhvillimin rajonal dhe vendor **si dhe me nenet 112 dhe 113 të MSA-së** që parashikojnë se Shqipëria mund të marrë asistencë financiare nga Bashkimi European në formë granti dhe huaje,

[Type here]

- **Nenin 8 “Marrëveshjet e financimit”, pika 2, të Marrëveshjes Kuadër** të lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit European për zbatimin e IPA II², që parashikon se marrëveshjet e financimit përcaktojnë, ndër të tjera, kushtet e menaxhimit të Asistencës IPA II, përfshirë metodat e zbatimit, intensitetin e ndihmës, afatet e zbatimit, si edhe rregullat për pranueshmërinë e shpenzimeve, **si dhe me Seksionin e VIII “Dispozitat për programet e bashkëpunimit ndërkufitar”** të Marrëveshjes Kuadër,
- **Nenin 2, pika 1, shkronja “a”, nënpika iii të Rregullores IPA II**, që parashikon se ndihma që BE-ja do të japë në kuadër të IPA II do të ndjekë arritjen e objektivave specifike të pëcaktuar në këtë Rregullore, sipas nevojave të secilit prej përfituesve të IPA II si dhe agjendës së tyre individuale të zgjerimit, duke përfshirë, mbështetje për reformat politike nëpërmjet ‘bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë’,
- **Nenin 3, pika 1, shkronja “e”, dhe pika 4 të Rregullores IPA II** që parashikojnë se asistenca e BE-së në fushën e ‘bashkëpunimi rajonal dhe territorial’, mund të financojë në veçanti veprime që përfshijnë shumë vende si dhe veprime të bashkëpunimit ndërkufitar, transkombëtar dhe ndërrajonal;
- **Nenin 6, pika 4 të Rregullores Zbatuese IPA II** që parashikon se një marrëveshje e vetme financimi për programet e bashkëpunimit ndërkufitar, mund të nënshkruhet nga të gjitha vendet pjesëmarrëse në një program specifik.

AXHENDA E ZHVILLIMI TË QËNDRUESHËM

Kuvendi i Shqipërisë, në vijim të miratimit të Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, ka miratuar rezolutën “Për objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara”

Në Rezolutën e Kuvendit parashikohet monitorimi i zbatimit të këtyre objektivave dhe për këtë është kërkuar nga Kryetari i Kuvendit që në relacionin e projektligjit, për një periudhë tranzitore deri në miratimin e rregullores (ndryshimi i nenit 68), të përfshihet edhe një zë i cili duhet të paraqesë se cila nga objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm synohet të përmirësohet.

Në relacionin e projektligjit nuk paraqitet asnjë referim në lidhje me përmirësimin e objektivave të Axhendës 2030

Komisioni vlerëson se ky projektligj ka tregues përmirësimi në zbatimin e kësaj marrëveshje dhe janë si më poshtë

Objektivi 4. Sigurimi i arsimit përfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i të nxënësve gjatë gjithë jetës.

Objektivi 13. Ndërmarrja e veprimeve urgjente për të luftuar ndryshimin e klimës dhe efektet e saj

² Ratifikuar me ligjin Nr.37/2015, datë 9.4.2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit European për rregullat e zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të instrumentit për asistencën e paraanëtarësimit (IPA II)”.

Objekti 15. Mbrojtja, rimëkëmbja dhe nxitja e shfrytëzimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, pyjeve të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme, luftimi i shkatërrimit, ndalimi dhe prapësimi i procesit të degradimit të tokës, si dhe ndalimi i humbjes së biodiversitetit.

Komisioni, pas shqyrtimit të projektligjit, e miratoi atë me shumicë votash

NËNKRYETARI

BLEDAR ÇUÇI